




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-03/DPK
 Dep. 04
 Nr. i faq.
 Broj stranica
 Nr. pages

Nr. Prot. 01-1664/16
 Br. Prot. Prot No
 Data 03-05-2016
 Datum Date

PRISHTINE



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	29/04/2016
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP-03-03/1337/16
PËR/ZA/TO:	z. Nuro ISMAILI Zyra e Prokurimit – Komuna Dragash
CC:	z. Salim JENUZI Kryetar Komune - Komuna Dragash
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI. Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderët: Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kukajan



I nderuar z. ISMAILI,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1 dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kukajan – K.K. Dragash me numër të prokurimit: 621/2016/017/536, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderët e lartcekur, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Arsyetim

Ju si zyre e prokurimit pranë autoriteti kontraktues Komuna Dragash keni iniciuar Procedurë Prokurimi për tenderin Kubëzimi i rrugëve në fshatin Kukajan – K.K. Dragash i cili është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 29/03/2016. Për këtë aktivitet të prokurimit keni paraparë procedurë të kuotimit të çmimit, kategoria punë. Gjithashtu në të njëjtën kohë keni hapur edhe disa tenderë të tjerë për punë të ngjashme, të cilët asnjëri prej tyre nuk ka kaluar vlerën e kuotimit të çmimit.

Katër aktivitete janë për kubëzim të rrugëve dhe një projekt është përmirësim i infrastrukturës, dhe vlera e parashikuar e gjithë këtyre pesë projekteve të ngjashme veç e veç është limiti maksimal i “kuotim çmimi” sa për të mos kaluar në vlerë të mesme. Si autoritet kontraktues duhet ta keni parasysh që kur një punë nën-ndahet në disa pjesë, dhe secila prej tyre është lëndë e kontratës së veçantë, vlera e përgjithshme e parashikuar e të gjitha sasive të tilla, duhet të shfrytëzohet për klasifikimin e secilës kontratë, pra është dashur ta zhvilloni një aktivitet prokurimi me lote të caktuara, ku secilin kuotim çmimi aktual, mund ta kishte ndarë në lote. Bashkimi i gjitha kuotimeve do të ngërthente në vete edhe parimin e ekonomizimit, duke i kursyer edhe mjetet publike, si dhe mjetet e operatorëve ekonomik duke fituar edhe në kohë.

Agjencia Kundër Korrupsion ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë kontrollimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia kundër Korrupsion ka hasur në shumë parregullsi që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Kosovës.

Pas kontrollimit të dokumentacionit të ofruar nga ju, Agjencia ka vërejtur se nuk keni përgatitur projektin ekzekutiv të punëve të cilat kanë për tu realizuar me aktivitetin e prokurimit i cili është në procedurë. Specifikat Teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës të punëve të kërkuara. Specifikat Teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutiv. Komuna Dragash në këtë rast është përgjegjëse për hartimin e Projekteve Ekzekutive për gjitha aktivitetet e publikuara të cilët në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjiten Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron gjithashtu se nuk keni zgjedhur procedurën e duhur për realizimin e punëve të caktuara. Ligji i prokurimit publik në Kosovë nuk lejon procedura prokurimi “Kuotim çmimi” për të realizuar punë, sipas po të njëjtit ligj parashihet që autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurat për kuotimin e çmimeve për të ushtruar një aktivitet të prokurimit që ka për qëllim dhënien e një kontrate të punëve, furnizimeve ose shërbimeve me vlerë minimale ose të vogël nëse: në rast të kontratave për punë përfshinë vetëm *riparime apo mirëmbajtje*, kubëzimi nuk cilësohet në këtë kategori.

Vlefshmërinë e tenderit në njoftim për kontratë e keni kërkuar 60 ditë ndërsa në dosjen e tenderit nuk e keni kërkuar fare. Kurdo që një aktivitet i prokurimit kërkon publikimin e njoftimit të kontratës, dosja e tenderit duhet të kompletohet para publikimit të njoftimit të kontratës. Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike.

Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 29/02/2016 kërkesë për shpalljen e tenderit, i pa nënshkruar e i pa vulosur.

Në procesverbalin e hapjes nuk është paraqitur në tabelë çmimi i ofertueseve – Rubrika e zbrazët, ndërsa në faqen e dytë shkruan përshkrimi i pozicionit, njësia si dhe emrat e operatorëve ekonomik të plotësuar në rubrike me disa shifra të cilat nuk dihet nëse bëhet fjalë për çmime ose jo.

Formulari i vlerësimi të ofertave nuk është i plotësuar me “PO” ose “JO” në rubrikat ku duhet të vlerësohet nëse Operatori Ekonomik i përmbushë kriteret ose jo. Vetëm në rubrikën e fundit të faqeve janë plotësuar me “PO”.

Çmimi në total nuk është paraqitur në formular ndërsa çmimi për njësi është paraqitur vetëm për Operatorin Ekonomik fitues. Formulari ka të bashkangjitur një shkresë “Raport Vlerësimi” në të cilën janë dhënë disa detaje, në mes tjerash edhe që Operatori Ekonomik fitues ka dëshmuar referencë të datës 30/03/2016, ndërsa njoftimi për kontratë mbanë datën 29/03/2016. Formulari gjithashtu ka të bashkangjitur edhe një shtojcë tjetër me tabelën e çmimeve të operatorëve ekonomik ofertues.

Gjithashtu nuk keni kërkuar mjetet e punës për realizimin e projektit, i cili pa mjetet e punës është e pamundur të realizohet.

Dosjen e kanë tërhequr 15 Operator Ekonomik, ndërsa kanë aplikuar 4 të tillë. Ofertuesit që kanë paraqitur aplikimet e tyre janë katër, të cilët i keni konsideruar si të përgjegjshëm, ndërsa Agjencia pas shqyrtimit të dokumentacionit të ofruar ka konstatuar se asnjëri nga operatorët ekonomik ofertues nuk janë të përgjegjshëm. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Për të gjitha aktivitetet e prokurimit, ju si autoritet kontraktues keni bërë njoftim për dhënie të kontratës dhe në katër prej pesë rasteve është rekomanduar për dhënie të kontratës Operatori Ekonomik “SHABANAJ”, i cili rezulton të jetë i pa përgjegjshëm në gjitha rastet.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 18 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës së Punëve, nenin 27 dosja e tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike, nenin 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve, si dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin Nr. 04/L -237 dhe ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkojmë nga ju si Autoriteti Kontraktues që t'i shmangni dhe të mos i përsërisni praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !